



Protokoli i shkurtë i mbledhjes së Kuvendit të dhjetë - jubilar të BISHZ-së të mbajtur më 24.11.2007

Vendi: Adresa: Hotel Novotel Bern Expo, Am Guisanplatz 2, 3014 Bern.
Data: **E shtunë, 24 nëntor 2007 / 15.03-18.30**
Protokoli: Abas Fejzullahi (sekretar)
Pjesëmarrës: Rreth 35

Pikat e rendit të ditës

Pjesa e parë: Kuvendi i dhjetë-jubilar

1. 15:30 Hapja e Kuvendit (Inxh. i dipl. Sinollah Shehu, nënkryetar)
2. 15:40 Fjala hyrëse dhe vështrim i shkurtë i punës dhjetëvjeçare të BISHZ-së (Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar)
3. 15:50 Paraqitja e raportit të punës së BISHZ-së për periudhën 18.11.2006 - 23.11.2007 (Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar)
16:00 Diskutim i hapur
4. 16:15 Zgjedhja e Kryesisë së re dhe Komisionit të kontroll-revizionit
 - Zgjedhja e Kryesisë së re sipas nenit 5c të Statutit (Të gjithë)
 - Zgjedhja e Komisionit të kontroll-revizionit sipas nenit 5d të Statutit (Të gjithë)
5. 16:30 Ndarja e mirënjohjeve (Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar)
6. 16:45 Të ndryshme (Të gjithë)
17:00 Mbyllja e Kuvendit (Inxh. i dipl. Sinollah Shehu, nënkryetar)

17:00 – 17:30 Pushim

Pjesa e dytë: Promovimi i Fjalorit enciklopedik nga teknologjia e informacionit me indeks shqip, anglisht, gjermanisht dhe frëngjisht i autorit inxh. i dipl. Ali Mehmeti.

- 17:30 Fjala hyrëse dhe paraqitje e shkurtër e jetëshkrimit të inxh. i. dipl. Ali Mehmeti (Dr. Sc. Ahmet Xhigoli)
17:40 Paraqitja e disa rezultateve të përkruara në fjalor (Ali Mehmeti, inxh. i dipl.)
18:10 Diskutime
18:30 Mbyllja e promovimit



Pjesa e parë: Kuvendi i dhjetë-jubilar

1. Hapja e Kuvendit (Inxh. i dipl. Sinollah Shehu, nënkryetar)

Sipas programit të paraparë z. Sinollah Shehu, nënkryetar, bëri hapjen e Kuvendit të dhjetë të rregullt jubilar dhe i përshëndeti të pranishmit në përgjithësi me një fjalim të shkurtër siç vijon: Këtë vit jubilar, 10 vjetorin e themelimit të Shoqatës nuk po e festojmë siç patëm dëshirë, në Kuvendin e kaluar që ta festojmë Kosovën Sovrane.

Në vazhdim me urime dhe dëshira dhe kërkesa ju drejtue edhe grupit të bisedimeve-Unitetit që të bëjnë punën me përgjegjësi lidhur me bisedimet për Kosovën dhe dëshirojmë që populli i Kosovës ti realizoi aspiratat sa ma shpejt për pavarësi. Në vazhdim ja dha fjalën kryetarit z. Ahmet Xhigolit ë vazhdoj me udhëheqjen e Kuvendit.

2. Fjala hyrëse dhe vështrim i shkurtër i punës nëntëvjeçare të BISHZ-së (Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar)

Kryetari z. Ahmet Xhigoli në mënyrë kronologjike duke përmbledhur veprimtarin dhjetëvjeçare të shoqatës paraqiti shkurtimisht aktivitetet e zhvilluara nga kryesia dhe anëtarët e shoqatës duke i falënderuar për bashkëpunim të gjithë anëtarët për kontributin e tyre të dhënë në mirëvajtjen e punës së shoqatës.

3. Paraqitja e raportit të punës së BISHZ-së për periudhën 18.11.2006-23.11.2007 (Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar)

Në mënyrë pamore të shkurtër dhe të thuktë paraqiti Raportin vjetor të punës nr. 10 me tekst dhe foto. Në vazhdim iu drejtua të pranishmëve dhe anëtarëve dhe kryesisë që Raportin vjetor nr.10, ta lexojnë që e kemi shtypur dhe po ashtu mund ta lexojnë edhe përmes Web-faqes së Shoqatës dhe të gjitha vërejtjetë t'i dergoni brenda dy javësh për të mundur që në mbledhjen e ardhme të Kryesisë të miratohet raporti me vërejtje e plotësime nëse ka.

Diskutim i hapur

Z. Ahmet Xhigoli ftoi të pranishmit që me diskutimet e tyre të dhënë ndihmesën e tyre në të gjitha drejtimet lidhur me punën e shoqatës.

Z. Sinollah Shehu propozoi: Që në Web-faqe të hapet një hapësirë e re (link) - Foto Galeri apo Video Galeri për vizitorët e faqës duke shpjeguar qëllimin dhe efektet që do të ketë.

Z. Adnan Mehmeti tha se kjo mund të realizohet, por duhet sistemuar fotot e përcjellur ato edhe me tekst dhe dha shpjegime.

Z. Ahmet Xhigoli lidhur me këtë propozim në vazhdim tha: Duhet formuar një grup punues për të bërë rregullimin, zgjedhjen, rradhitjen dhe strukturimin e fotografive që kemi mjaft në arkivin e shoqatës dhe përcjellur e përshtatur edhe tekstin përcjellës.

Z. Xhevat Salihu, mes tjerash tha se një hapësirë e tillë e re (link) mund të ketë kundër efekt për vizitorët, sepse shiqon fotot e lënë pa lexuar materialet e rëndësishme të shkruara si raporte të mbledhjeve etj.

Z. Sinollah Shehu tha se më duket s'jam drejtëkuptuar, sepse përmes kësaj hapësire te re (linku) është që të përkujton vizitorëve lidhur me fotot dhe aktivitetet tjera përmes teksteve të shkruara.

Z. Besim Gërxhaliu, të gjitha takimet e ardhme familjare e aktivitete tjera të publikohen në Web-faqe të Shoqatës në formë informate etj.



4. Zgjedhja e Kryesisë së re, Komisionit të kontroll-revizionit dhe Komisionit Statutar

- **Zgjedhja e Kryesisë së re**

Në këtë pikë të rendit të ditës z. Ahmet Xhigoli pas sqarimeve që bëri për propozimet e Kryesisë së re dhe diskutimet dhe vendimet e marrura të Kryesisë në mbledhjet e mëparshme, si ndryshimi i Statutit lidhur me kohëzgjatjen e zgjedhjeve të reja nga 2 në 4 vite sipas Statutit, neni 7.1.c. u hudh në votim, së pari ndryshimi i statutit, së dyti zgjedhja e Kryetarit dhe anëtarëve të kryesisë re, dhe së treti u votua zgjedhja e Komisionit të kontroll-revizionit sipas nenit 7.1.d, dhe Komisionit statutar të Shoqatës.

Kuvendi, njëzëri votoi dhe zgjodhi Kryesinë e re në këtë përbërje:

1. Abas Fejzullahi, Kryetar
2. Florije Rexhaj, Nënkryetare
3. Besim Gërxhaliu, Sekretar
4. Shkumbin Rmoku, Arkëtar
5. Xhevat Saliu, këshilltar
6. Sinollah Shehu, këshilltar
7. Ahmet Xhigoli, këshilltar
8. Ismet Rexhaj, këshilltar
9. Adnan Mehmeti, këshilltar
10. Valbona Krasniqi, këshilltare
11. Resmije Berisha, këshilltare
12. Gani Balaj, këshilltar
13. Agim Gerbavci, këshilltar

- **Zgjedhja e Komisionit të kontroll-revizionit**

Në këtë pikë, Kuvendi njëzëri votoi dhe zgjodhi Komisionin e kontroll-revizionit në përbërje:

1. Ismet Rexhaj, kryetar
2. Florim Thaçi, anëtar
3. Ramiz Shabani, anëtar

- **Zgjedhja e Komisionit Statutar**

Në këtë pikë, Kuvendi njëzëri votoi dhe zgjodhi Komisionin Statutar në përbërje:

1. Valbona Krasniqi, kryetare
2. Gani Balaj, anëtar
3. Adnan Mehmeti, anëtar



5. Ndarja e mirënjohjeve (Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar)

Kryetari z. Ahmet Xhigoli pasi njoftoi të pranishmit lidhur me ndarjen e mirënjohjeve që shoqata bën për anëtarët edhe personalitetet që s'janë anëtarë të shoqatës por që me veprimtarin dhe kontributin e tyre sipas vlerësimeve u ndahen mirënjohje. Për mirënjohjet e ndara lexoj dhe arsyetimin dhe për çfarë veprimtarie i ndahet mirënjohja secilit siç vijon:

| Nr. | Emri dhe mbiemri | Përmbajtja e tekstit | Propozuar dhe arsyetuar nga |
|-----|------------------|---|-----------------------------|
| 1. | Elida Buçpapaj | Për ndihmesë të veçantë dhe përkrahje të veprimtarisë së Shoqatës që nga themelimi. | Dr. Sc. Ahmet Xhigoli |
| 2. | Haxhi Zyba | Për kontribut të veçantë për çështjen kombëtare. | Abas Fejzullahi |
| 3. | Skënder Buçpapaj | Për ndihmesë të veçantë dhe përkrahje të veprimtarisë së Shoqatës që nga themelimi. | Dr. Sc. Ahmet Xhigoli |
| 4. | Salih Kabashi | Për ndihmesë të veçantë dhe përkrahje të veprimtarisë së Shoqatës që nga themelimi. | Dr. Sc. Ahmet Xhigoli |
| 5. | Resmije Berisha | Për ndihmesën dhe kontributin e dhënë shoqatës në periudhën 2005-2007 | Abas Fejzullahi |
| 6. | Vehbi Skënderi | Për kontribut të veçantë për kulturën dhe letërsinë shqiptare. | Abas Fejzullahi |

6. Të ndryshme

Me që në pikën e ndryshme s'pat ndonjë diskutim të veçantë, propozimi ishte të bëhet pushimi në pjesën para sallës të hotelit me freskimin e pijeve dhe bisedave të lira mes anëtarëve dhe mysafirve të shoqatës, atmosferë kjo që kaloi mjaft mirë nga bisedimet e lira e të ndryshme sipas zgjedhjeve individuale e grupe.

Pjesa e dytë: Promovimi i Fjalorit enciklopedik nga teknologjia e informacionit me indeks shqip, anglisht, gjermanisht dhe frëngjisht i autorit inxh. i dipl. Ali Mehmeti.

Z. Ahmet Xhigoli dha arsyetimin e mungesës së autorit dhe kërkimfaljen për këtë mungesë nga autori i fjalorit që sot ne po e promovojm. Me që z. Ahmet Xhigoli e njipte këtë lëmi dha shpjegime profesionale lidhur me rëndësin e Fjalorit në fjalë dhe shpjegimet që i ka bërë autori termave nga drejtimi teknik dhe informatika që do t' ju ndihmon përdoruesve të këtij fjalori.

Pas këtyre shpjegimeve nga z. Ahmet Xhigoli, s'pat diskutime tjera.

Z. Sinollah Shehu ja dha fjalën Abas Fejzullahit si kryetar i sapo zgjedhur i cili në mes tjerash tha: Falënderoi kryesinë dhe anëtarët tjerë për besimin e dhënë dhe mendoi se edhe në të ardhmen do punojmë bashkërisht si deri tani dhe sipas bashkëpunimit të mirëfillët e mirëkuptimit mund të pasurojmë dhe ndryshojmë veprimet organizative me ide e veprime të reja e konstruktive dhe për këtë bashkëpunim në të ardhmen ju falënderoi.

Me këtë nënkryetari z. Sinollah Shehu spalli të mbyllur Kuvendin e dhjetë jubilar të BISHZ-së sipas kohës së planifikuar.

Shënimet i mbajti she shkruajti: *Abas Fejzullahi, sekretar i BISHZ-së
Solothurn, 24 nëntor 2007*